

Në bazë të nenit 24-a, paragrafit 17 të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

për mënyrën dhe kriteret më të përafërta për organizimin dhe realizimin e garave të nxënësve në lëndë të veçanta në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret më të përafërta për organizimin dhe realizimin e garave të nxënësve në lëndë të veçanta në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm.

Neni 2

1) Garat organizohen me qëllim vlerësimin dhe renditjen e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të nxënësve në lëndë, fusha ose kualifikime të veçanta në arsimin profesional.

2) Përmbajtja e garave është e përshtatur me moshën e nxënësve dhe bazohet në planet dhe programet mësimore për arsimin e mesëm.

Neni 3

1) Garat organizohen në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror.

2) Garat komunale, rajonale dhe shtetërore organizohen nga shoqata të akredituara të mësimdhënësve (në tekstin e mëtejshëm: shoqata e mësimdhënësve) sipas lëndëve të veçanta, fushave ose kualifikimeve në arsimin profesional.

3) Të drejtë pjesëmarrjeje në garën shtetërore kanë nxënësit që në garën komunale ose rajonale kanë arritur rezultate në përputhje me kriteret e përcaktuara nga shoqatat e mësimdhënësve.

4) Nëse në nivel komunal ose rajonal nuk ekzistojnë kushte për organizimin e garës komunale ose rajonale, në përputhje me nenin 10 të kësaj rregullore, nxënësit kanë të drejtë të marrin pjesë drejtpërdrejtë në garën shtetërore.

II. QËLLIMET DHE DETYRAT E GARAVE

Neni 4

Qëllimet e organizimit dhe realizimit të garave janë:

- vlerësimi i nivelit të njohurive, aftësive dhe shkathtësive të fituara nga nxënësi;
- identifikimi dhe afirmimi i shkollave përmes rezultateve të nxënësve të tyre, me qëllim avancimin e reputacionit dhe atraktivitetit të tyre;
- identifikimi i nxënësve që janë me dhunti ose të talentuar në një fushë të caktuar;
- pasurimi i procesit mësimor me përmbajtje të zgjeruar dhe të thelluar për nxënësit që tregojnë interes në lëndë të veçanta mësimore;
- përmirësimi i cilësisë së arsimit;
- promovimi i arritjeve të nxënësve dhe i punës edukativo-arsimore të shkollave të mesme;
- inkurajimi i shpirtit konkurrues, punës në ekip dhe zhvillimi i tolerancës tek nxënësit; dhe
- pjesëmarrje në gara ndërkombëtare.

Neni 5

Garat mbahet për shkak të:

- shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet mësimdhënësve;
- inkurajimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- promovimi i nxënësve;
- zgjerimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet shkollave, si dhe bashkëpunimi i tyre me institucione të tjera;
- promovimi mediatik i arritjeve në punën edukativo-arsimore dhe
- promovimi i përgjegjësisë shoqërore të kompanive si formë mbështetjeje për garat.

III. ORGANIZIMI I GARAVE

Neni 6

- 1) Për organizimin e garave, shoqata e mësimdhënësve parashtron kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) për akreditim dhe organizim të garave pas shpalljes së thirrjes publike.
- 2) Thirrja publike nga paragrafi (1) i këtij neni publikohet në ueb faqen e Ministrisë në tremujorin e katërt të vitit aktual.
- 3) Gjatë parashtrimit të kërkesës për akreditim, shoqata e mësimdhënësve dorëzon dokumentacion konform nenit 24-a paragrafit (8) të Ligjit për Arsimin e Mesëm.
- 4) Nëse në Thirrjen publike paraqiten dy ose më shumë shoqata të mësimdhënësve që i përmbushin kushtet nga neni 24-a, paragrafi (7) dhe (8) të Ligjit për Arsimin e Mesëm, Komisioni për akreditimin e shoqatave të mësimdhënësve vendos bazuar në kriteret shtesë.
- 5) Kriteret shtesë nga paragrafi (4) i këtij neni janë:
 - në pesë (5) vitet e fundit, shoqata e mësimdhënësve ka fituar vende, çmime ose medalje në gara ndërkombëtare dhe olimpiada shkencore ndërkombëtare, ku kanë marrë pjesë me ekipin e vet ose ku udhëheqës kanë qenë anëtarë të shoqatës (dëshmi: fotokopje të diplomave/certifikatave për vendet/çmimet e fituara nga nxënësit dhe certifikata për pjesëmarrjen e udhëheqësve);

- 6) Kriteri shtesë nuk do të merret parasysh nga Komisioni për akreditimin nëse shoqata e mësimdhënësve që ka dorëzuar kërkesë për akreditim të ri, më parë i është hequr akreditimi për shkak të parregullsive të konstatuara gjatë zbatimit të garave në periudhë prej tre (3) vitesh nga dita e aplikimit. Në rast të tillë, përparësi kanë shoqatat e tjera që kanë aplikuar në thirrjen publike, nëse i përmbushin kushtet nga neni 24-a, paragrafi (7) dhe (8) të Ligjit për Arsimin e Mesëm.
- 7) Shoqata e mësimdhënësve për organizimin e garave akreditohet për periudhë prej tre vite shkollore.
- 8) Për organizimin e garave akreditohet nga një shoqatë të mësimdhënësve për lëndë të veçantë, fusha ose kualifikime në arsimin profesional.
- 9) Për pjesëmarrjen e nxënësve në garat komunale, rajonale dhe shtetërore, për të cilat shkolla ose themeluesi siguron mjete për kotizim, është e detyrueshme renditje paraprake të nxënësve në nivel shkollor, në përputhje me planin e mëparshëm të kriterëve të përcaktuara nga ana e këshillit të mësimdhënësve të shkollës.
- 10) Plani i kriterëve nga paragrafi 9 i këtij neni përgatitet bazuar në:
 - Propozime për gara nga mësimdhënësit e shkollës, të përgatitura nga grupet profesionale të mësimdhënësve për fusha të caktuara, bazuar në numrin e nxënësve me dhunti ose të talentuar dhe/ose të dhënë për lëndët përkatëse të fushës së grupit.
 - Mundësitë financiare të shkollës për mbulimin e shpenzimeve të tarifës së pjesëmarrjes për pjesëmarrjen në gara dhe kuota e përcaktuar për numrin e nxënësve për të cilët shkolla dhe/ose komuna mund të paguajë taksën për çdo lëndë, fushë ose kualifikim në arsimin profesional për të cilat është planifikuar pjesëmarrja në garë.
 - Minimumi i pikëve të përcaktuara për pjesëmarrje në nivel më të lartë të garës (komunale, rajonale dhe shtetërore) për lëndë të veçanta, fusha ose kualifikime në arsimin profesional.
- 11) Numri i nxënësve që kanë të drejtë për pjesëmarrje falas në nivel më të lartë të garës (komunale, rajonale dhe shtetërore) përcaktohet me vendim të këshillit të mësimdhënësve të shkollës, në përputhje me planin vjetor financiar të shkollës dhe bazuar në planin e përcaktuar nga paragrafi (10) i këtij neni.
- 12) Minimumi i pikëve për pjesëmarrje në nivel më të lartë të garës përcaktohet me vendim të këshillit të mësimdhënësve të shkollës, ndërsa me propozim nga aktivi i mësimdhënësve për lëndë të veçanta mësimore, fusha ose kualifikime në arsimin profesional.
- 13) Nxënësit që janë renditur për nivel më të lartë të garës (komunale, rajonale dhe shtetërore), sipas kuotës së përcaktuar për çdo lëndë mësimore, lirohen nga taksa e regjistrimit, ndërsa shpenzimet mbulohen nga shkolla ose themeluesi.
- 14) Nxënësit që nuk janë ranguar brenda kuotës së përcaktuar për lëndën, fushën ose kualifikimin në arsimin profesional në garën shkollore mund të vazhdojnë në nivel më të lartë të garimit vetëm nëse plotësojnë pikët minimale të përcaktuara nga paragrafi (10), alinea (3) i këtij neni.
- 15) Për nxënësit nga paragrafi (14), tarifa e regjistrimit paguhet nga prindërit ose kujdestarët e nxënësve.
- 16) Garat detyrimisht planifikohen në programin vjetor të punës së shkollës.
- 17) Shoqata e mësimdhënësve në ueb faqen e saj çdo vit shpall publikisht pyetjet, detyrat dhe/ose temat që janë përdorur në garat komunale, rajonale dhe shtetërore të nxënësve nga viti i kaluar. Po ashtu, ato duhet të përkthehen në të gjitha gjuhët mësimore në të cilat ka pasur pjesëmarrës në garat.

1)Shoqatat e mësimdhënësve në kuadër të kalendarit trevjeçar për realizimin e garave komunale, rajonale dhe shtetërore në shkollat e mesme, e përcaktojnë muajin dhe vitin e mbajtjes së garave në nivelin përkatës (komunal, rajonal dhe shtetëror).

2) Datat përfundimtare dhe koha e mbajtjes së garave përcaktohen pas koordinimit paraprak ndërmjet kryetarëve të shoqatave të akredituara, me qëllim që të shmanget mbivendosja e datave të garave.

3)Datat dhe koha nga paragrafi (2) i këtij neni publikohen nga shoqatat e mësimdhënësve në ueb faqen e tyre zyrtare.

Neni 8

1) Shoqata e mësimdhënësve, me rregulloren për organizimin e garave, përcakton mënyrën e organizimit të garave, kriteret më të përafërta për organizimin dhe realizimin e garave, qëllimet e garave dhe vlerësimin e rezultateve të nxënësve.

2) Shoqatave të mësimdhënësve do t'iu merret akreditimi në rastet e mëposhtme:

- për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për Arsimin e Mesëm dhe kësaj Rregullore;
- nëse pyetjet e garës nuk janë në përputhje me programin mësimor;
- nëse nuk respektohen kriteret për organizimin e garave;
- nëse ka mospërputhje në renditjen e testeve; ose
- për shkak të mosrespektimit të konfidencialitetit të testeve.

3) Pas parashtrimit të fletëparaqitjes nga nxënësit/mësimdhënësit deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës në lidhje me parregullsitë e identifikuar në zbatimin e garave nga shoqatat e mësimdhënësve ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri) formon Komision për përcaktimin e parregullsive.

4) Pas parashtrimit të fletëparaqitjes për parregullsi të identifikuar në zbatimin e garave komunale dhe/ose rajonale nga nxënësit/mësimdhënësit, shoqata formon Komision për përcaktimin e parregullsive, ndërsa përgjegjësinë e mban shoqata.

5) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni përbëhet nga tre anëtarë, dhe atë: një anëtar nga Ministria, nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, respektivisht Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional, dhe nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

6) Komisioni për konstatimin e parregullsive mund ta refuzojë fletëparaqitjen e parashtruar si të pa bazë ,t'i japë shoqatës së mësimdhënësve vërejtje me shkrim për të eliminuar parregullsitë e konstatuara brenda afatit të caktuar, ose t'i propozojë ministrit heqjen e akreditimit të shoqatës së mësimdhënësve.

7) Nëse shoqata e mësimdhënësve nuk i eliminon parregullsitë brenda afatit të caktuar, Komisioni për konstatimin e parregullsive i propozon ministrit heqjen e akreditimit të shoqatës së mësimdhënësve.

IV. KRITERET MË TË PËRAFËRTA PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E GARAVE KOMUNALE, RAJONALE DHE SHTETËRORE

Neni 9

Kriteret e përafërta për organizimin dhe realizimin e garave të nxënësve për lëndë të veçanta mësimore, fusha ose kualifikime në arsimin profesional janë si vijon:

- Shoqatat e akredituara të mësimdhënësve organizojnë gara komunale, rajonale dhe shtetërore për lëndët e mësimore, fushat ose kualifikimet,
 - Gara shtetërore për lëndë të veçantë mësimore, fushat ose kualifikime, mund të mbahet vetëm nëse janë paraqitur të paktën tre nxënës.
- nxënësi garon në gjuhën në të cilën ndjek mësimin, përveç në rastet kur merr pjesë në garë për gjuhën amtare ose gjuhën e huaj,
- për pjesëmarrjen e nxënësve në çdo nivel të radhës të garave (komunale, rajonale dhe shtetërore), përzgjedhja bëhet bazuar në rezultatet e arritura dhe listën e renditjes nga nivelet e mëparshme të garave,
- kalimi i nxënësve në nivel më të lartë të garave, përkatësisht në garat rajonale dhe/ose shtetërore, kryhet sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara nga shoqata e mësimdhënësve.
 - nëse për vendin e parë në garë në nivel shtetëror disa nxënës ose grupe nxënësish arrijnë të njëjtin numër pikësh, shoqata e mësimdhënësve që e organizon garën përcakton kriteret shtesë, në përputhje me Rregulloren për organizimin e garave të shoqatës së mësimdhënësve,
 - shoqata e mësimdhënësve që organizon garën në nivel shtetëror mund të shpallë vetëm një nxënës ose vetëm një grup nxënësish si fitues të vendit të parë të garës,
 - nikoqir i garës shtetërore mund të jetë instituti/institucioni i caktuar nga shoqata e mësimdhënësve me pëlqimin paraprak të marrë nga drejtuesi i institutit/institucionit,
 - përmbajtjet/programet për garat në lëndë, fusha ose kualifikime të veçanta mësimore i përcakton shoqata e mësimdhënësve në përputhje me planet-programet mësimore,
 - kohëzgjatja e garës dhe numri i pyetjeve/detyrave përcaktohet nga shoqata e mësimdhënësve që e realizon garën,
 - vëzhguesit që ndjekin garën i përcakton shoqata e mësimdhënësve në bashkëpunim me personin drejtues të shkollës, përkatësisht fakultetit,
 - mënyrën e verifikimit të njohurive, aftësive, shkathtësive dhe kapaciteteve, përkatësisht mënyrën e prezantimit personal dhe interpretimit artistik, e përcaktojnë komisionet të formuara nga shoqata e mësimdhënësve që realizon garën,
 - nxënësi i pakënaqur i garës (nxënësi ose mësimdhënësi i tij) mund të parashtrojë kundërshtesë deri te Komisioni për Vendimmarrje mbi Kundërshtesat, të formuar nga shoqata e mësimdhënësve organizator i garës nga neni 11 paragrafi (7),
 - periudha kohore për vendimmarrje mbi kundërshtesën e parashtruar nga alinea 13 të këtij neni dhe për publikimin e rezultateve përfundimtare nga organizatori i garës nuk duhet të jetë më e gjatë se pesë ditë pune nga dita e publikimit të rang-listës preleminare,
 - shoqata e mësimdhënësve pas mbajtjes së garave përgatitë shkallën e pikëve të nevojshme për fitimin e çmimeve dhe për vendin e parë, të dytë ose të tretë të fituar në garë shtetërore për lëndë të veçantë ose fushë ose kualifikim mësimor, nxënësi merr diplomë, mësimdhënësi i tij certifikatë, ndërsa për pjesëmarrësit e tjerë shoqata e mësimdhënësve mund të lëshojë diplomë për vendin e parë, të dytë ose të tretë të fituar dhe vërtetim/mirënjohje për pjesëmarrje në garë.
 - ndarja e çmimeve (parë, dytë dhe i treti) bëhet bazuar në shkallën e pikëve nga alinea 15 i këtij neni, ku disa nxënës ose grupe nxënësish mund të fitojnë të njëjtin çmim. Shpallja e vendit të parë bëhet ndërmjet nxënësve ose grupeve që kanë marrë çmimin e parë, ku mund të zgjidhet vetëm një nxënës ose një grup nxënësish -ai/ajo që ka fituar numrin më të madh të pikëve sipas shkallës.

- 1)Pagesa e tarifës së regjistrimit përfshin të gjitha tre nivelet e garës: komunale, rajonale dhe shtetërore.
- 2)Nëse ka vetëm një shkollë të mesme në një komunë të caktuar dhe për këtë arsye nuk organizohet asnjë garë komunale, tarifa e regjistrimit mbulon garën rajonale dhe shtetërore në lëndën mësimore përkatëse , përkatësisht fushën përkatëse, gjegjësisht kualifikimin në arsimin profesional.
- 3)Nëse në kuadër të rajonit të caktuar nuk janë paraqitur nxënës nga më shumë komuna dhe nuk ka kushte për organizimin e garës rajonale, nxënësit e paraqitur marrin pjesë drejtpërdrejtë në garën shtetërore.
- 4)Pavarësisht nëse gara organizohet në një komunë ose rajon të caktuar në përputhje me paragrafin (2) dhe (3) të këtij neni, tarifa e regjistrimit të shoqatës është e detyrueshme dhe mbulon organizimin e garave në të tre nivelet: komunal, rajonal dhe shtetëror.

V. VLERËSIMI, RENDITJA DHE NJOFTIMI I REZULTATEVE TË GARAVE

Neni 11

1)Mënyra e vlerësimit të rezultateve dhe renditja e nxënësve në garë janë në kompetencë të komisionit për vlerësimin e rezultateve dhe renditjen, i cili, varësisht llojit të garës, mund të jetë komision komunal, rajonal ose komision për garë shtetërore, formuar nga shoqata e mësimdhënësi.

2)Komisioni për garën shtetërore përbëhet nga të paktën tre anëtarë nga radhët e anëtarëve të shoqatës së mësimdhënësve që e organizon garën.

3)Gjatë mbajtjes së garës shtetërore është e detyrueshme pjesëmarrja e përfaqësuesit nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, respektivisht nga Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional, si vëzhgues.

4)Shoqata e mësimdhënësve dorëzon me kohë kërkesë me shkrim ose përmes adresës zyrtare elektronike te Byroja për Zhvillimin e Arsimit, respektivisht te Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional, për nominimin e vëzhguesit për garën shtetërore.

5)Vëzhguesi nga paragrafi 3 i këtij neni kryen mbikqyrjen e kontrollit të njohurive të nxënësve në garën shtetërore.

6)Rang-lista preliminare nga gara është publike dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të shoqatës së mësimdhënësve.

7)Shoqata e mësimdhënësve formon Komision për Vendimmarrje mbi Kundërshtesa, i përbërë nga të paktën tre (3) anëtarë nga radhët e anëtarëve të shoqatës që organizon garën. Numri total i anëtarëve të Komisionit përcaktohet nga kryetari i shoqatës, varësisht numrit të kundërshtesave të pranuar.

8)Rang-lista përfundimtare nga gara është publike dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të shoqatës së mësimdhënësve, pasi komisioni nga paragrafi 7 i këtij neni shqyrton kundërshtesat.

9)Shoqata e mësimdhënësve mund të përcaktojë edhe lloje të tjera çmimesh për pjesëmarrësit në garë, si dhe çmime nga donatorët dhe sponsorët.

10)Diplomat, certifikatat, vërtetimet dhe mirënjohjet nënshkruhen nga kryetari i shoqatës së mësimdhënësve.

Neni 12

1) Shoqata e mësimdhënësve, pas përfundimit të garave, jo më vonë se 15 ditë, në faqen e saj të internetit publikon raport për rezultatet nga të gjitha nivelet e garimit.

2) Shoqata e mësimdhënësve pas përfundimit të garës shtetërore, në Ministri dorëzon raport për rezultatet e garës, jo më vonë se 30 ditë pas publikimit të rang listave përfundimtare.

3) Raporti nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të përmbajë të dhënat në vazhdim:

- emri i garës dhe emri i shoqatës së mësimdhënësve që e ka organizuar garën,
- vendi dhe koha e mbajtjes së garës,
- numri i pjesëmarrësve, numri i nxënësve të shpërblyer, mësimdhënësit e tyre (pasqyra tabelare – emri dhe mbiemri i nxënësit/grupit të nxënësve, emri dhe mbiemri i mësimdhënësit të tyre, viti shkollor/paralelja, vendi i fituar, emri dhe vendndodhja e shkollës ku mëson nxënësi),
- 4) lidhjet deri te tabelat me rezultatet përfundimtare nga të gjitha nivelet e garës të publikuara në ueb faqen e shoqatës,
- 5) pasqyra tabelare e numrit të pjesëmarrësve sipas klasave në të gjitha nivelet e garës,
- 6) pasqyra tabelare e numrit të pjesëmarrësve të shpërblyer sipas klasave në të gjitha nivelet e garimit.

VI. APLIKIMI ELEKTRONIK I VENDEVE TË FITUARA NË GARA SHTETËRORE

Neni 13

1) Për vendin e parë të fituar në garën shtetërore gjatë vitit vijues shkollor, nxënësi ose grupi i nxënësve, respektivisht mësimdhënësi i tyre, plotësojnë aplikimin elektronik dhe ngarkojnë dokumentacionin përkatës në formë elektronike deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke përdorur mjetet për identifikim elektronik përmes Portalit Kombëtar për Shërbime Elektronike ose përmes ndërmjetësuesit për shërbime administrative në mënyrë elektronike, në përputhje me dispozitat në fushën e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike, si dhe në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besueshme.

2) Aplikimi nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet më së voni deri më 31 dhjetor të vitit në të cilin organizohet gara shtetërore, në përputhje me nenin 24-a paragrafin (16) të Ligjit për Arsimin e Mesëm.

3) Aplikimi elektronik duhet të përmbajë të dhënat dhe dëshmitë e mëposhtme:

- Emri dhe mbiemri i nxënësit/grupit të nxënësve, respektivisht i mësimdhënësit të tyre;
- Diploma për nxënësin dhe certifikata për mësimdhënësin e tij;
- Adresa e vendbanimit, kontakt telefoni dhe adresa elektronike e nxënësit dhe e mësimdhënësit të tij.
- NVAQ i nxënësit dhe i mësimdhënësit të tij;
- Numri i llogarisë rrjedhëse dhe emri i bankës depozitues për nxënësin dhe mësimdhënësin e tij;
- Deklaratë për dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Për të përfunduar procesin e organizimit dhe realizimit të garave nga shoqatat e mësimdhënësve të akredituara, të cilave akreditimet u skadojnë gjatë viteve shkollore 2025/2026 ose 2026/2027 ose 2027/2028, të njejtat të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në fund të viteve shkollore të shënuara.

Neni 15

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën dhe kriteret më të përafërta për organizimin dhe realizimin e garave të nxënësve në lëndë të veçanta në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm, nr. 19-2249/1 të datës 05.03.2013, nr. 20-2928/1 të datës 02.03.2017, nr. 13-5583/1 të datës 29.03.2021, nr. 13-5583/2 të datës 31.03.2021 dhe nr. 13-3711/1 të datës 29.03.2024.

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas miratimit të saj.

**МИНИСТЕРКА ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА,
MINISTRE E ARSIMIT DHE SHKENCËS
проф. д-р Весна Јаневска**

Nr.13-15652/1

15.12.2025

Shkup